**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**
FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA TË BIZNESIT – PEJË
**INFORMACION**
PËR MBAJTJEN E PROVIMIT PRANUES NË FSHAB – PEJË

| Nr | Data | Ngjarja | Shpjegim për detyrimin tuaj |
|---|---|---|---|
| 1. | 16.07.2010 deri më 26.07.2010 | **Konkurrimi dhe paraqitja e dokumenteve** | ▪ Paraqitja e dokumenteve behët në Zyrat e Administratës së FSHAB-së, çdo ditë pune me orar, prej orës 10.00 – 12.00 dhe prej orës 13.00 – 15 .00 .<br>▪ Dokumentet e nevojshme për konkurrim janë të paraqitura në konkurs ?.<br>▪ Përgatitja e provimit behët nga manuali për provim pranues, i cili gjendet në skriptoren e fakultetit.<br>▪ Për studentët të cilët tentojnë të aplikojnë me dokumentacion duplikat rregullat do të shpallen në www.fshab.org |
| 2. | 28.07.2010 Ora 14.00 | **Shpallja e listave të kandidatëve që do t'i nënshtrohen provimit pranues** | ▪ Listat me emrat e studentëve, sallat dhe orën për nënshtrim të provimit pranues do të publikohen në ueb faqen e fakultetit **www.fshab.org** , nëse emri juaj nuk figuron në këto lista duhet të paraqiteni në fakultet aty ku i keni dorëzuar dokumentet që të rregullohen gabimet, me datën 29.07.2010 prej orës 10,00-14,00.<br>▪ Njoftoheni se për çdo informatë që ka te beje me procedurën e regjistrimit Lajmërimet, shpalljet, publikimet dhe informacionet tjera mund t'i gjeni vetëm në www.fshab.org.<br>▪ Në hapësirat e fakultetit nuk do të ketë asnjë shpallje të gjitha do t'i gjeni në ueb faqe. |
| 3. | 30.07.2010 ora 9.00 | **Mbajtja e provimit pranues** | ▪ Të gjithë kandidatët të cilët do t'i nënshtrohen këtij provimi duhet të posedojnë dokument identifikimi me fotografi (letërnjoftim, pasaportë etj.), në të kundërtën do ta humbin të drejtën e hyrjes në provim.<br>▪ Njoftohen te gjithë kandidatet se është e ndaluar ardhja ne hapësirat e Fakultetit me persona tjerë ( prind, kujdestar etj.),<br>▪ Në ueb faqe me datën 28.07.2010 do të publikohet orari i detajizuar me orë dhe salla ku do të mbahet provimi pranues dhe do të jetë i obligueshëm të respektohet nga ana e juaj.<br>▪ Ardhja në Fakultet duhet te behet sipas oraret e t'i përcaktuar ne liste respektivisht 15 minuta me herët. |
| 4. | 05.08.2010 | **Shpallja e rezultatit** | ▪ Shpallja e rezultatit do të behët në web faqen e fakultetit, www.fshab.org.<br>▪ Sipas afatit dhe kohës së paraparë në konkursin publik |
| 5. | 06.08.2010 | **Ankesat për studentet e papranuar** | ▪ Studentet te cilët nuk pranohen dhe pretendojnë te ankohen se mospranimi i tyre është rezultat i ndonjë parregullsie janë te obliguar qe me datën 06.08.2010 nga ora 10 deri në orën 12.00 ta paraqesin ankesën me shkrim drejtuar komisionit për ankesa.<br>▪ Formularin e ankesës mund ta shkarkoni nga ueb faqja e fakultetit dhe dorëzohen ne zyrën e protokollit. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 6. | 18.08.2010 | **Regjistrimi i kandidatëve të pranuar** | ▪ Behët regjistrimi i kandidatëve të cilët kanë kaluar provimin pranues dhe janë pranuar në FSHAB së bashku me dokumentet e nevojshme që janë të parapara në konkurs , nëse nuk paraqiteni në këtë datë ju do të zëvendësoheni me kandidatët tjerë<br>▪ Kërkohet: potësimi i fletëregjistrimit që do të gjindet në fakultet, tri fotografi të formatit 4.5X6 cm.<br>▪ Pagesa për studentë të rregulltë në lartësi prej 90 Euro për një semestër dhe<br>▪ Pagesa për studentë me korrespondencë në lartësi prej 250 euro për një semestër. |

## Vërejtje:

Kërkojmë nga kandidatët për studentë të ardhshëm që i takojnë kategorive: Anëtarë të familjeve të dëshmorëve, invalidë të luftës, fëmijë të invalidëve të luftës, veteranë të luftës dhe fëmijë bonjakë të viktimave civile të luftës që të sjellin dëshmi për këtë status në mënyrë që Komisioni i pranimit studentëve të fakultetit të ketë mundësi t'u llogarisë bonusin në 10% sipas kushteve të konkursit për regjistrimin e studentëve në vitin e parë akademik 2010/2011.

Administrata e fakultetit tonë do t'ua pranojë këto dëshmi deri me datën 26.07.2010

Duke iu dëshiruar sukses menaxhmenti i FSHAB-së do të u jetë shumë mirënjohës për respektimin e rregullave të përcaktuara nga UP-ja për mbarëvajtjen e provimit pranues.

# Çdo informatë do ta gjeni vetëm në www.fshab.org